



Funded by
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



ISP
INSTITUTI I STUDIMEVE POLITIKE
INSTITUTE FOR POLITICAL STUDIES
www.isp.com.al



Datë: 10 Gusht 2020

FAQ **(Frequently Asked Questions)**

Pyetjet më të shpeshta dhe përgjigjet nga Sesionet Informuese **të zhvilluara në kuadër të Thirrjes për Projekt-Propozime**

1. **Pyetje:** Ju falenderoj për njoftimin dhe për mundësinë për organizatat, por do doja të jepja një keshillë/sygjerim/ kritike, në lidhje me raportin e auditit që kërkohej në paketën e aplikimit pasi personalisht me duket pak penalizuese për organizatat e vogla, pasi jo të gjitha e kanë mundësinë për të marrë shtesën e jashtëm të auditimit bazuar në tarifën financiare që ka dhe kjo mund të jetë skualifikuese për shumicën e organizatave (bazuar nga biseda edhe me kolege të sektorit). Nuk e di nëse mund të kancelohej kërkesa për një dokument të ketillë?

Përgjigje: Duke marrë në konsideratë kërkesat dhe nevojat e Organizatave të Shoqërisë Civile, me qëllim për të thjeshtuar procesin e aplikimit në këtë thirrje, kriteri për dorëzimin e raportit të auditit është ndryshuar. Ndryshimet konsistojnë në parashikimin e dorëzimit të këtij dokumenti nëse OShC-të e disponojnë atë. Nëse OShC-të nuk e disponojnë një dokument të tillë, **mungesa e tij nuk do të përbëjë një kriter penalizues apo skualifikues.** Për më tepër ju lutem gjeni më poshtë Corrigendum No 1 të Udhëzimit për Aplikantët në linkun më poshtë:

<https://ahc.org.al/ep-content/uploads/2020/07/Corrigendum-No-1-to-Guidelines.pdf>

2. **Pyetje:** Në listën e dokumentave të kërkuara në thirrjen tuaj për propozime nr 3 është dhe marrja e ekstraktit nga gjykata. Ne jemi interesuar dhe stafit na ka thënë se gjykata është e mbyllur gjatë gjithë muajit gusht dhe nuk leshon dokument të tillë deri në shtator, nderkohe deadline juaj është 31 gusht. A mund të dorëzojmë kopjen e vendimit të fundit të gjykatës vetëm?

Përgjigje: Ju mund të dërgoni një kopje të fundit të ekstraktit të gjykatës të cilin e dispononi, edhe nëse është më i vjetër se 6 muajt e fundit nga periudha e thirrjes, me shpjegimin e arsytuar si më lart. Pas mbarimit të afatit për aplikime (31 Gusht) do të bëhet vlerësimi administrativ, ku gjatë kësaj periudhe ju duhet të dërgoni pranë KShH-së ekstraktin e përditësuar të marrë nga Gjykata gjatë ditëve të para të muajit Shtator.

3. **Pyetje:** A ka afat kohor për ekzistencën historike/vjetërsinë e organizatave që mund të aplikojnë, psh organizata që kanë 2 vite ose më shumë që janë themeluar?

Përgjigje: Nuk ka kufizime kohore mbi kohëzgjatjen e veprimtarisë së organizatave që mund të aplikojnë në këtë thirrje. Projekt propozimet pranohen nga të gjitha organizatat që plotësojnë kriteret e vendosura në seksionin 2.1 të Udhëzimit për Aplikantët, si dhe dorëzojnë dokumentacionin e nevojshëm sipas pikës 2.2 të të njëjtit Udhëzues.

4. **Pyetje:** Duke marrë në konsideratë se nënshkrimi i kontratës së grantit me fituesit mund të bëhet rreth muajit Tetor 2020, faktin se Zgjedhjet Parlamentare mund të organizohen rreth muajit Qershor-Korrik 2021, si dhe kohëzgjatjen e parashikuar në Udhëzues se projektet mund të jenë 8-12 muaj, a mund të parashikohet që projekti të zgjase tej datës së Zgjedhjeve?



Funded by
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



Përgjigje: Projektet me të cilat mund të aplikojnë organizatat e shoqërisë civile mund të zgjasin deri në 12 muaj dhe mund të parashikohen të zbatohen një pjesë të aktiviteteve edhe tej datës së vendosur nga Presidenti i Republikës për tu realizuar procesi i Zgjedhjeve Parlamentare 2021. Të tilla mund të jenë aktivitete të cilat përfshijnë hartimin e raporteve të monitorimit, research, policy paper, materiale studimore, etj. Megjithatë, nëse projekti do të parashikojë një sërë aktiviteteve sensibilizuese/ndërgjegjësuese, organizatat fituese pritet ti zbatohen këto aktivitete para ditës së zgjedhjeve me qëllim rritjen e pjesëmarrjes në një proces të tillë.

5. **Pyetje:** A do të njihet TVSH-ja për organizatat të cilat do të shpallen fituese të thirrjes?

Përgjigje: Po, për organizatat fituese do të njihet TVSH-ja, si dhe mbështetja financiare do të jetë 100% pa kërkuar bashkëfinancim nga vetë OShC-ja.

6. **Pyetje:** A mund të dorëzohen dokumentat e aplikimit në gjuhën shqipe, pasi përkthimi dhe noterizimi i tyre ka një kosto ekstra për organizatat.

Përgjigje: Me qëllim për të thjeshtëzuar procesin e aplikimit, bazuar në pikën 2.2 të Udhëzuesit për Aplikantët “Lista e dokumenteve të kërkuara, mund të dorëzohen në 3 forma: si kopje të thjeshta, si kopje të noterizuara, dhe/ose si version origjinal, në shqip dhe/ose në anglisht.”

**Ky parashikim është i vlefshëm vetëm për dokumentacionin shoqëruar, i cili lëshohet në gjuhën shqipe nga institucionet shqiptare dhe nuk vlen për projekt-propozimin. Projekt-propozimi duhet të ndjekë formatet e parashikuara paraprakisht dhe duhet të jetë i hartuar në anglisht!*

7. **Pyetje:** Zonat e parashikuara ku mund të zbatohet projekti, janë në bazë qarku apo në bazë bashkie?

Përgjigje: Në këtë thirrje për projekt propozime mund të aplikojnë organizata për zbatimin e projekteve në 9 Bashki: Tirana, Durrës, Kukës, Shkodra, Elbasan, Korçë, Fier, Vlora and Gjirokastra.

8. **Pyetje:** A duhet të depozitohet bashkë-aplikanti të njëjtin dokumentacion si aplikanti kryesor?

Përgjigje: Në fazën e aplikimit, bashkë-aplikanti duhet të dorëzojë vetëm formatin “Declaration by the co-applicant”. Lista e dokumentave të parashikuara duhet të dorëzohet vetëm nga aplikanti kryesor (Lead Applicant). Aplikanti kryesor është i vetmi entitet që mban përgjegjësi para Konsorciumit të Organizatave, prandaj duhet të marrë në konsideratë paraprakisht plotësimin e kushteve të njëjta edhe për bashkë-aplikantin me të cilin zgjedh të bashkëpunojë.

9. **Pyetje:** A mund të parashikojnë aktivitete për monitorimin e zgjedhjeve edhe organizatat e shoqërisë civile apo monitorimi do të bëhet vetëm nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit?

Përgjigje: OShC-të mund të parashikojnë aktivitete me qëllim monitorimin e aspekteve të ndryshme të progresit të Zgjedhjeve Parlamentare 2021 (si regjistrimi i kandidatëve dhe votuesve, fushatat, financimi i partive politike, puna e administratës zgjedhore dhe organeve të tjerë relevantë, dita e zgjedhjeve, procesi i votimit dhe numërimit etj). KSHH do të monitorojë procesin parazgjedhor, ditën e zgjedhjeve dhe pas-zgjedhor në 9 qytetet e parashikuara. Nëse OShC-të aplikuese parashikojnë monitorime të ngjashme, nëse shpallen fitues, do të këtë një koordinim sa më të mirë në mënyrë që të krijohet një sinergji mes veprimtarive të organizatave si dhe të shmanget mbivendosja.



Funded by
the European Union



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE
KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT



10. **Pyetje:** Në varësi të situatës së pandemisë në vend, duke marrë në konsideratë kufizime potenciale deri në ri-mbyllje të vendit si pasoje e COVID-19, a do të ketë fleksibilitet në rishikimin e aktiviteteve dhe përshtatjen e tyre në formate të tjera si online?

Përgjigje: Në varësi të zhvillimeve në vend, akteve normative të miratuara nga Këshilli i Ministrave/Kuvendi në kuadër të pandemisë Covid-19, por duke patur në konsideratë edhe politikat apo udhëzimet e dhëna nga Bashkimi Evropian për entitetet e financuara prej tij me grante apo në forma të tjera, Konsorciumi i Organizatave do të jetë mbështetës dhe fleksibël për OShC-të fituese për të marrë në shqyrtim propozimet dhe alternativa të zbatimit të aktiviteteve që i përgjigjen situatës së Covid 19, në përputhje me qëllimin dhe natyrën e projektit të deklaruar fitues.

Vazhdon...¹

¹ Komiteti Shqiptar i Helsinkit mirëpret pyetje apo kërkesa për sqarim nga organizatat e interesuara për të aplikuar në Thirrjen për Projekt-Propozime deri më datë 15 Gusht 2020. Kjo liste më pyetje të shpeshta do të përditësohet nëse do të ketë pyetje të tjera të adresuara nga OShC-të.